



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 597/15 Prot.

Tiranë, më 22. 09. 2025

V E N D I M

Nr. 219, Datë 22. 09. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur, ankesa nr.86, datë 07.04.2025, e z. S. F.¹, dhe z. M. Gj.,² në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga linja e transportit të udhëtarëve ndërqytetase Berat- Fier-Berat. Në këtë ankesë z. S. F., dhe z. M. Gj., përfaqësohen nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *Më datë 12.03.2025, unë S. F., president i shoqatës “Shpresë për të Verbërit”, së bashku me M. Gj., anëtar i kësaj shoqate, në zbatim të vendimit të bordit drejtues, për ndalimin e diskriminimit nga kompanitë e transportit të shërbimit publik interurban, për moszbatimin e ligjit 8098, nenit I, inspektuam linjën Tiranë-Berat, Berat-Fier dhe Fier-Tiranë. Linja Tiranë-Berat dhe Fier-Tiranë e zbatonin ligjin dhe nuk patëm probleme, ndërsa linja Berat-Fier, autobusi me targë AA639DV, që u nis nga Berati për në Fier në orën 13:00 ose 13:10 dhe që mbërritëm në Fier rreth orës 14:00 ose 14:10, nuk e njihite ligjin 8098, neni 1. Shoferi që drejtonte autobusin nuk na çoi deri në stacion, por na zbriti sa u fut në qytet, duke na lënë në rrugë. Përveç kësaj, ai nuk na dha as bileta, por na kërcënoi duke na thënë se deri këtu e kam rrugën dhe nuk ju dërgoj më poshtë, duke shtuar se mjetin e kam privat dhe unë ndalohem ku të kem qejf dhe si marr leje kujt. Na detyroi të paguanim biletën e*

¹ Referuar Librezës së Verbërisë nr. 25980, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, ankuesi është i verbër Grupi i I-të.

² Referuar Librezës së Verbërisë nr. 13100, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, ankuesi është i verbër Grupi i II-të

plotë, pasi ai na tha se nuk më duhen librezat tuaja, më duhen vetëm lekët. Duke qenë se ishim shumë larg stacionit të trenit, ku nisen autobusat nga Fieri për në Tiranë, nuk debatuam shumë me të dhe bëmë pagesën. Ai kërkoi nga 3000 lekë të vjetra për person, duke paguar biletën e plotë si çdo qytetar tjetër.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të saj nga ana e kompanisë së transportit ndërqytetar, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe eliminimit të pasojave për shkak të tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohej *ndaj çdo veprimi apo mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës rezultoi se pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin, i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Berat-Fier-Berat dhe mjetin me të cilin kishte udhëtuar në datë 12.03.2025, ditë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 597/2, datë 10.04.2025, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

Gjithashtu, pas analizimit paraprak të ankesës rezultoi se kishte mangësi të anës formale që lidhen me faktimin apo provueshmërinë e pretendimit të diskriminimit nga ana e shoferit të autobusit me targë AA 639 DV, që ofron shërbimin në linjën e e transportit.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 597/3, datë 10.04.2025, i është drejtuar për marrjen e informacionit palës ankuese nga e cila është kërkuar se:
 - Të saktësohet fakti nëse gjatë këtij udhëtimi i keni paraqitur librezat Tuaja, nëse po, cilin dokument i keni paraqitur shoferit të autobusit: Librezën e Verbërisë së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror apo Librezën e Verbërisë së lëshuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve, si dhe të depozitoni një kopje të librezës së paraqitur.
 - Identifikimin e personit me të cilin keni komunikuar dhe pretendoni që keni pasur konfliktin. (shofer/fatorino)

Me shkresën nr. 7454/1 prot., datë, 14.04.2025³, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Nga verifikimi në Udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar, dhe në platformën elektronike eTransport, rezulton se mjeti me targë AA 639 DV, nuk është mjet i licensuar për linjën Berat-Fier-Berat.

Mjeti me targë AA 639 DV, rezulton në pronësi të shoqërisë “Star 2002”, sh.p.k., me NIPT L63204002T dhe është i pajisur me certifikatë operimi nr.9, datë 24.12.2024, me afat

³ Administruar pranë Komisionerit me nr.597/4 prot., datë 16.04.2025.

vlefshmërie deri në datë 24.12.2025 në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës së udhëtarëve Ura Vajgurore- Fier- Ura Vajgurore.

Shoqëria “Star 2002”, sh.p.k, është mbajtës i Licencës nr. 275, datë 10.10.2022, me afat vlefshmërie deri në datën 09.10.2027 dhe referuar kësaj licence, vendi i nisjes është Ura Vajgurore në oraret 7⁰⁰, 8⁰⁰, 10⁰⁰ dhe oraret e kthimit 9⁰⁰, 10⁰⁰, 14⁰⁰.

- Në vijim të trajtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke marrë shkas nga moskthimi i një përgjigje nga ankuesit në lidhje me informacionin e kërkuar, por dhe duke marrë shkas nga përgjigja e kthyer nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, i është drejtuar përsëri palës ankuese me shkresën nr. 597/5 prot., datë 18.04.2025, ku ka kërkuar si më poshtë vijon:

Me shkresën nr. 597/3 prot., datë 10.04.2025 të Komisionerit ju është kërkuar informacion shtesë lidhur me pretendimet e ngritura në ankesën tuaj. Nga ana juaj nuk është dërguar asnjë informacion përse ju është kërkuar me këtë shkresë. Gjithashtu me shkresën nr. 597/3 prot., datë 10.04.2025, Komisioneri i është drejtuar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me qëllim identifikimin e pronësisë së mjetit me targat AA639DV, që ju pretendoni që keni udhëtuar. Referuar përgjigjes së këtij institucioni rezultoi se mjeti me targat AA639DV nuk operon në linjën që ju keni udhëtuar.

Në këto kushte, lidhur me provueshmërinë e këtij momenti i cili lidhet drejtëpërdrejtë me pretendimin tuaj për diskriminim, ju lutemi, të shpjegoni se:

- *Të jepni informacion dhe shpjegime të hollësishme ku të saktësoni dhe identifikoni mjetin me të cilin keni udhëtuar dhe që ofron shërbimin e transportit urban në linjës Berat-Fier.*
- *Identifikimin e personit me të cilin keni komunikuar dhe pretendoni që keni patur konfliktin.*

Me shkresën 697/6 prot., datë 24.04.2025 është administruar pranë Komisionerit, përgjigja e palës ankuese, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Pëveç targës së mjetit, orarit të nisjes, vendit të nisjes, vendit të mbërritjes nuk kemi fakt tjetër për tu paraqitur. Së pari ishim të dy të verbër, njëri i grupit A dhe tjetri i grupit B, ka qenë e pamundur të identifikojmë gjëra të tjera. Në lidhje me librezën nuk bëhet fjalë se cilën librezën por me zbatimin e ligjit.

Pas plotësimit të ankesës dhe identifikimit të subjektit, u konstatua se nga pikëpamja formale, ankesa objekt shqyrtimi plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 dhe 334 të LMD. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj, duke ndërmarë hapat e mëposhtme:

- Me shkresën nr.597/7 prot., datë 06.05.2025, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria “Star 2000” sh.p.k, me NIPT L6304002T, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Shoqëria Shoqëria “Star 2002” sh.p.k me e-mailin 27.05.2025, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar,

duke sqaruar ndër të tjera se: *Ju falënderoj për vendosjen në dijeni të shoqërisë “Star 2002” sh.p.k., lidhur me ankesën e regjistruar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*

Ndjesë për vonesën në kthimin e përgjigjes, por ditën e djeshme kam marrë dijeni kur kam kontrolluar email-in, pasi jam kthyer nga pushimet vjetore, dhe jam angazhuar plotësisht për të qartësuar çështjen.

Unë, në pozicionin e menaxherit të shoqërisë “Star 2002”, nuk jam informuar në asnjë rast më parë për një problem të tillë, jo vetëm në mjetin për të cilin është regjistruar ankesa, por në asnjë prej mjeteve në të gjitha linjat e transportit ndërqytetas, ku shoqëria “Star 2002” operon.

Kam komunikuar në mënyrë të menjëhershme me drejtuesin e mjetit AA639DV, i cili është shprehur i habitur nga ankesa e dërguar prej z. S. F., dhe z. M. Gj. Ai mohon që të kenë qenë dy persona me aftësi të kufizuara duke udhëtuar në linjën që ai drejton dhe mohojnë të ketë pasur ndonjë incident me atë lloj reagimi që shkruhet në ankesë.

Pretendimi i parë, ku thuhet “Shoferi që drejtonte autobusin nuk na çoi deri në stacion, por na zbriti sapo u fut në qytet, duke na lënë në rrugë”, është mohuar nga drejtuesi i mjetit AA639DV, i cili është shumë i qartë lidhur me stacionet e miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për linjën që operon dhe i respekton ato.

Mjeti me targat AA639DV, sqarojmë se në orarin e përmendur në ankesë kryen itinerarin Fier-Urë Vajgurore pasi oraret e licensuara janë konkretisht: nisje nga Ura Vajgurore në oraret 7⁰⁰, 8⁰⁰, 10⁰⁰ dhe oraret e kthimit nga Fieri drejt Urës-Vjgurore 9⁰⁰, 10⁰⁰, 14⁰⁰.

Pretendimi i dytë, ku thuhet “ai nuk na dha as bileta, por na kërcënoi duke na thënë se deri këtu e kam rrugën dhe nuk ju dërgoj më poshtë, duke shtuar se mjetin e kam privat dhe unë ndalohej ku të kem qejf, s’i marr leje kujt”, është mohuar nga drejtuesi i mjetit AA639DV, i cili jo vetëm që pajis të gjithë pasagjerët me biletë, por e kryen detyrën me respekt të plotë dhe me një komunikim të sjellshëm kundrejt çdo pasagjeri që udhëton rregullisht apo rastësisht. Gjithashtu, mjeti nuk është i drejtuesit të mjetit, por i shoqërisë, dhe mjeti ndalon vetëm në stacionet e miratuara, e jo aty ku ka qejf drejtuesi i mjetit.

Pretendimi i tretë, ku thuhet “Na detyroi të paguanim biletën e plotë, pasi ai na tha se nuk më duhen librezat tuaja, më duhen vetëm lekët”, po ashtu është kundërshtuar nga drejtuesi i mjetit, i cili është plotësisht i qartë lidhur me dispozitat ligjore për lehtësirat financiare të parashikuara për transportin e personave me aftësi të kufizuara. Kjo dispozitë është edhe pjesë e dispozitave të përgjithshme në “Çertifikatën për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetase”, me të cilën është i pajisur çdo mjet i yni, specifikisht pika 4:

“4. Mbajtësi i licencës dhe i kësaj certifikate mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr. 7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet:

a) Për transportin qytetas:

“Invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë falas”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, nr. 8153/96, të ndryshuar:

“Të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas.”

b) Për transportin rrethqytetas dhe ndërqytetas:

Mbajtësi i licencës mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr. 7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93; nr. 8626/00, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet:

“Invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë me 50% të vlerës së biletës”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, të ndryshuar, nr. 8153/96:

“Të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas.”

Drejtuesi i mjetit ka shtuar se ai as nuk ua kërkon dëshminë pasagjerëve, të cilët gëzojnë këto të drejta, dhe i respekton lehtësirat që ofrohen për ta duke u mjaftuar me vetëdeklarimin e tyre si të tillë. Për më tepër, drejtuesi i mjetit është shprehur se, jo vetëm për pasagjerët që gëzojnë këto të drejta, por edhe për pasagjerë të tjerë, të rregullt ose të rastësishëm, të cilët vetëdeklarohen se nuk kanë mundësi ekonomike për të paguar tarifën e biletës, u ofrohet shërbimi falas duke pasur parasysh vështirësitë që kanë familjet në zonat që linja operon. Kjo është një nga këshillat që i gjithë stafi ynë ka marrë prej nesh gjatë trajnimeve dhe komunikimeve mes njeri-tjetrit për të dhënë sadopak kontribut në përmirësimin dhe lehtësimin e transportit publik për qytetarët në Republikën e Shqipërisë.

Të marrësh këtë lloj ankese absolutisht të pavërtetë dhe cenuesë, duke pasur parasysh respektin që të gjithë drejtuesit e mjeteve gëzojnë nga pasagjerët në linjat që ne operojmë, është shumë e padrejtë si për drejtuesin e mjetit, ashtu edhe për shoqërinë tonë. Gjithashtu mjeti me targa AA639DV nuk operon në linjën Berat-Fier sikurse janë shprehur ankuesit por operon në linjën Ura-Vajgurore – Fier.

Dua t'ju informoj se shoqëria “Star 2002” sh.p.k., me objekt aktiviteti kryesor “Transport rrugor i udhëtarëve brenda vendit”, respekton çdo dispozitë ligjore, duke përfshirë këtu edhe ofrimin e transportit të personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve

brenda vendit”, e cituar edhe në “Çertifikatën për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetase”, me të cilën është i pajisur çdo mjet i yni.

Uroj që të kem mirëkuptimin tuaj dhe mbetem i hapur për çdo lloj paqartësie apo informacioni shtesë që mund t’ju nevojitet.

- Me shkresën nr.597/8 prot., datë 29.05.2025, është administruar shkresa nr. 579/1 prot., datë 26.05.2025 e Task-Forcës për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Motorike e Rimorkiove të Tyre, me anë të cilës vë në dijeni Komisionerin se: *Nga ana e Task-Forcës për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Motorike e Rimorkiove të Tyre, mbështetur në detyrat funksionale dhe kompetencat që i njeh ligji, me qëllim vlerësimin sa më të drejtë dhe objektiv, është bërë monitorimi dhe kontrolli në terren nga ana e specialistëve të autorizuar, mbi mjetin objekt ankese me targa AA 639 DV i subjektit “Star 2002” sh.p.k., nga ku ka rezultuar se ky mjet nuk është konstatuar në lëvizje në intererarin dhe oraret e pretenduara në ankesë. Bejmë me dije se Task-Forca për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Motorike e Rimorkiove të Tyre, do të vazhdojë të jetë në monitorim të ankesës dhe në rast konstatimi të shkelejeve, do të merren të gjitha masat përkatëse sipas dispozitave ligjore.*
- Me shkresën nr.597/9 prot., datë 02.06.2025, Komisioneri, i ka përcjellë ankuesve qëndrimin e mbajtur nga Shoqëria “Star 2002” sh.p.k., në lidhje me këtë çështje, për të bërë parashtrimet e tija. Subjekti ankues, sipas Fletës së Lajmërim-Marrjes së Zyrës Postare nr. RR 788 437 676 AA, datë 02.06.2025, rezulton se ka marrë në dorëzim shkresën nr. 597/9 prot., datë 02.06.2025 të Komisionerit, por nuk dërgoi asnjë përgjigje përsa iu kërkua.
- Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁴, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri pasi vlerësoi kërkesën e palës ankuese, caktoi datën 16.07.2025 ora 10.00 për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr.597/12 prot., datë 02.07.2025.

Me anë të një emaili të datës 15.07.2025, pala ankuese njoftoi Komisionerin si më poshtë: *“Përshëndetje të nderuar. Na keni informuar se më datë 16.07.2025 do të mbahet seanca dëgjimore në lidhje me ankesën e paraqitur nga S. F., dhe M. Gj., kundër linjës së transportit publik Berat–Fier. Ju bëjmë me dije se, për shkak të pamundësisë, as unë, S. F., dhe as M. Gj., nuk do të mund të marrim pjesë në këtë seancë dëgjimore. Ne i qëndrojmë të njëjtave pretendime si në ankesën e bërë më parë.”*

Në vijim të komunikimit, nga ana e inspektorit të çështjes është bërë me dije administratorit të Shoqërisë “Star 2002”, z. O., se pala tjetër nuk do të jetë e pranishme në seancën dëgjimore të planifikuar. Ndër të tjera z. O., u shpreh se: *Unë, si administrator i shoqërisë, dëshiroj të ritheksoj se ka shumë mundësi që të ketë ndodhur një keqkuptim me identifikim i mjetit, pasi shoqëria që unë përfaqësoj nuk ka përshkuar dhe nuk ofron shërbim në itinerarin e përmendur në ankesë. E*

⁴ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”*

pyetëm edhe shoferin që përdor mjedin me targat e përmendura në ankesë, i cili është shprehur se nuk ka ndodhur ndonjëherë një situatë e tillë. Madje, në çdo rast kur persona janë shprehur se gëzojnë një status të tillë, ka mjaftuar që ta deklarojnë dhe nuk u është kërkuar të paraqesin as librezën.

Ky pretendim na ka shqetësuar ndjeshëm, pasi për më shumë se një dekadë në këtë aktivitet, shoqëria jonë ka ushtruar detyrën me përkushtim, profesionalizëm dhe ndjeshmëri të lartë shoqërore, veçanërisht në raport me personat me aftësi të kufizuara. Shërbimi ynë ka qenë i bazuar jo vetëm në detyrime ligjore, por mbi të gjitha në ndjenjën e përgjegjësisë qytetare. Besoj se është në të mirën e të gjithëve që çdo keqkuptim i mundshëm të zgjidhet në mënyrë konstruktive, për të ruajtur jo vetëm të vërtetën, por edhe dinjitetin, moralin dhe emrin e mirë të shoqërisë sonë, veçanërisht në raste të natyrës së ndjeshme siç është një ankesë me karakter diskriminues. Shoqëria jonë mbetet e angazhuar dhe në gatishmëri për bashkëpunim të plotë me strukturat e Komisionerit dhe çdo institucion tjetër përkatës.

Sa më sipër, seanca dëgjimore e planifikuar në datën 16.07.2025 ora 10.00 nuk u zhvillua.

Duke marrë shkas nga kërkesa e palës ankuese për caktimin e një seance tjetër dhe për autorizimin e një përfaqësuesi tjetër nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe me qëllim sqarimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të çështjes, Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesën e palës ankuese, caktoi datën 27.08.2025, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 597/13 prot., datë 18.08.2025. Sipas fletës së lajmrimit-marrjes së Zyrës Postare, të dyja palët rezultojnë ta kenë marrë njoftimin e dërguar nga institucioni i Komisionerit.

Seanca dëgjimore e planifikuar më datë 27.08.2025, ora 10:00, nuk u zhvillua, pasi asnjëra nga palët nuk u paraqit në këtë seancë.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar nga institucionet dhe subjektet, informacionin e nevojshëm, lidhur me rastin e pretenduar nga pala ankuese, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ka mbajtur qendrimin se: “...aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast institucionit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga personat me aftësi të kufizuar (viktima e diskriminimit) te institucioni (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij....”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ankuesit, z.S. F., dhe z. M. Gj., të përfaqësuar në këtë ankesë nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, paraqitën një ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar gjatë udhëtimit me një mjet transporti publik në linjën Berat-Fier. Sipas ankesës, më datë 12.03.2025, gjatë një inspektimi për zbatimin e ligjit, në linjat ndërqytetëse, ankuesit janë trajtuar në mënyrë diskriminuese nga shoferi i autobusit me targë AA639DV. Ky i fundit nuk u ofroi bileta, nuk respektoi stacionin e zbritjes duke i lënë në rrugë, refuzoi të njihte dokumentacionin për udhëtim të personave me aftësi të kufizuara dhe i detyroi të paguanin çmimin e plotë të biletës, duke i shoqëruar me sjellje kërcënuese dhe deklarime diskriminuese.

Në bazë të fakteve të paraqitura nga pala ankuese, konstatohet se as në ankesën fillestare dhe as në korrespondencën pasuese, pala ankuese nuk ka bërë të ditur nëse personat e përfshirë në këtë udhëtim kanë paraqitur librezën e verbërisë, cilën prej librezave posedojnë dhe cilën prej tyre iu kanë paraqitur drejtuesit të mjetit në momentin e udhëtimit.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat për identifikimin e subjektit që pretendohet të ketë kryer veprimin diskriminues, duke komunikuar me DPSHTRR dhe me subjektin ankues.

Në përgjigjen e dhënë nga DPSHTRR dhe referuar ankesës së paraqitur, rezulton se mjeti me targë AA 639 DV, i përmendur nga pala ankuese, nuk është i licensuar për të operuar në linjën Berat–Fier–Berat, por në linjën Ura Vajgurore–Fier–Ura Vajgurore, dhe nuk niset nga Berati, siç pretendohet në ankesë por nga Ura Vajgurore.

Gjithashtu, oraret e nisjes dhe kthimit të këtij mjeti, sipas licencës së lëshuar nga DPSHTRR, nuk përputhen me oraret e deklaruar nga pala ankuese. Pala ankuese sipas përgjigjes së kthyer nuk kishte arritur të identifikonte në mënyrë të saktë subjektin që ofronte shërbimin e transportit në datën 12.03.2025, ditë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese.

Shoqëria “Star 2002” sh.p.k., përmes administratorit të saj, në përgjigje të ankesës së paraqitur nga z. S. F., dhe z. M. Gj., ka mohuar kategorikisht çdo formë diskriminimi apo trajtimi të padrejtë ndaj personave me aftësi të kufizuara. Administratori sqaroi se nuk kishte dijeni për rastin deri në

momentin e njoftimit dhe pas verifikimeve me drejtuesin e mjetit AA639DV, ky i fundit mohoi të ketë pasur incidentin e përshkruar në ankesë. Shoqëria theksoi se mjeti në fjalë nuk operon në linjën Berat-Fier, por në linjën Ura Vajgurore-Fier, dhe është i pajisur me licencë të rregullt. Ai nënvizoi gjithashtu angazhimin për respektimin e legjislacionit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe aplikimin e lehtësirave financiare që u takojnë, duke sqaruar se çdo drejtues mjeti në këtë kompani është i udhëzuar të ofrojë ndihmë dhe mirëkuptim ndaj çdo pasagjeri, pa përjashtim. Ankesa u cilësua si e pabazë dhe cënuesë për imazhin e kompanisë dhe për etikën e punës së personelit të saj.

Bazuar në të dhënat e administruara më sipër, Komisioneri, në kuadër të evidentimit të rastit, ka konstatuar se:

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) ka konfirmuar se mjeti me targë AA 639 DV nuk është i licencuar për linjën Berat–Fier–Berat, por operon në linjën Ura Vajgurore–Fier–Ura Vajgurore dhe është në pronësi të shoqërisë “Star 2002” sh.p.k.
- Orari dhe vendi i nisjes së mjetit të përmendur nuk përputhen me informacionin e deklaruar në ankesë, duke krijuar një mospërputhje të qartë faktike midis itinerarit të pretenduar nga pala ankuese dhe itinerarit real të mjetit të identifikuar.
- Shoqëria “Star 2002” sh.p.k. ka konfirmuar gjithashtu se mjeti me targë AA 639 DV nuk operon në linjën Berat-Fier, siç pretendohet në ankesë, por ndjek një linjë tjetër të miratuar dhe të licencuar.
- Shoqëria “Star 2002” sh.p.k., në komunikimin zyrtar me Komisionerin, ka sqaruar se pas marrjes dijeni për ankesën, drejtuesi i mjetit ka mohuar të ketë pasur dijeni apo përfshirje në një incident të natyrës së pretenduar nga pala ankuese.
- Task-Forca për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Motorike e Rimorkiove të Tyre, me shkresën nr. 579/1 prot., datë 26.05.2025 ndër të tjera ka informuar Komisionerin se nga monitorimi dhe kontrolli në terren, mjeti me targa AA 639 DV i subjektit “Star 2002”sh.p.k., nuk është konstatuar në lëvizje në intererarin dhe oraret e pretenduara në ankesë.
- Pavarësisht kërkesave të përsëritura të Komisionerit, pala ankuese nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme, përfshirë dokumentin përkatës të librezës së verbërisë që pretendohet të jetë paraqitur gjatë udhëtimit, apo identifikimin e saktë të personit me të cilin thuhet se ka ndodhur konflikti (shofer apo fatorino).
- Pretendimet e palës ankuese, në lidhje me tarifimin e plotë të biletës, mungesën e biletave të udhëtimit dhe sjelljen diskriminuese të drejtuesit të mjetit, janë kundërshtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shoqëria “Star 2002”, e cila ka deklaruar se respekton detyrimet ligjore për trajtimin me përparësi dhe lehtësira të personave me aftësi të kufizuara.

Referuar fakteve dhe rrethanave të administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se, nga informacioni i siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Task-Forca për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Motorike e Rimorkiove të Tyre,

dhe nga shoqëria “Star 2002” sh.p.k., nuk rezulton të provohet fakti i pretenduar nga pala ankuese lidhur me ndodhjen e incidentit të raportuar në ankesë

Gjithashtu, pala ankuese nuk ka vënë në dispozicion informacion të plotë, të detajuar dhe të mbështetur në prova konkrete, që do të mundësonin vërtetimin e ngjarjes së pretenduar. Mungesa e identifikimit të saktë të subjektit, mospërputhja në itinerar dhe orare, si dhe pamundësia për të administruar dokumentacion mbështetës (identiteti i personave të përfshirë në incident), e bëjnë të pamundur faktimin e një sjelljeje diskriminuese nga ana e shoqërisë “Star 2002” sh.p.k. ndaj ankuesve.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, bazuar në faktet dhe provat që janë vënë në dispozicion nga palët, si dhe atyre të grumbulluara gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk arriti të konstatojë se subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë “Star 2002” sh.p.k.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Shoqëria “Star 2002” sh.p.k, nuk duhet të gjendet përgjegjëse për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2024 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar në dëm të ankuesve, z. S. F., dhe z. M. Gj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. S. F., dhe z. M. Gj., përfaqësuar nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, në fushën e shërbimeve, nga ana e Shoqërisë “Star 2002”, sh.p.k., për shkak të “aftësisë së kufizuar”.
2. Rekomandohet Shoqëria “Star 2002” sh.p.k, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për mënyrën e ofrimit të udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në

bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA